



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr ~~400-56359~~ dt. 28.12 2020

Bazuar në nenin 11,12,dhe 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 34, pika 34. 6, të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 Nr. 320-19332, për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Rregullores MF-NR 04/2017, mbi Kritret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vendimit me Nr. 12/400-37743, të datës 03.07.2018, për plotësim- ndryshimin e Rregullores Nr. 12-320-19338, për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, vendimit, 01.Nr.020/04-50214, të dt. 23.11.2020, si dhe buxhetit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2020, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë, **28.12.2020**, të miratoj këtë:

V E N D I M

PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

Neni 1

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin “Ngritja e mirëqenjes sociale të personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre”, të Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “Handikos”, lidhur me mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e aktiviteteve për vitin 2020.

Neni 2

Projekti i Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS”- “Ngritja e mirëqenjes sociale të personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre”, përkrahet në shumën prej 4.000 € (katër mijë euro), mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2020.

Neni 3

Financimi- Subvencionimi i projektit do të bëhet nga kategoria ekonomike e shpenzimeve subvencione dhe transfere/ kodi ekonomik 21/611/73010/21200/0760 të parapara me Buxhetin për vitin 2020 të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Neni 4

Mjetet financiare barten në konton e Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS”, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozimvendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga OJQ “HANDIKOS”, që të bëjë raport narrativ-me shkrim dhe financiar në mënyrë që të njoftojë DSHMS-në për mënyrën e shpenzimit të mjeteve.

Neni 5

Për zbatimin Vendimit do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Ky vendim hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi Komunal i Drenasit si dhe nënshkrimi nga ana e kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit .



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj